

KONTRIBUTI I AKADEMIK ALI HADRIT PËR NGRITJEN E KUADRAVE SHKENCORE

Akademik Ali Hadri është njëri ndër personalitetet më të spikatura të arsimit, kulturës dhe shkencës shqiptare.



I vetëdijshëm se pa arsimimin kombëtar nuk ka ndërgjegjësim dhe ngritje të vetëdijes kombëtare, ai tërë jetën e vet ia kushtoi kësaj çështje dhe pa dyshim ia arriti qëllimit.

Është e njohur puna vetëmohuese dhe kontributi i tij në procesin e arsimit si profesor i historisë në shkollat e mesme në Pejë dhe Prishtinë. Hadri nuk ishte vetëm ligjërues i shkëlqyeshëm i lëndës së historisë por edhe frymëzues në ngritjen e vetëdijes kombëtare. Ish nxënësit e tij që tani janë intelektual të shquar e kujtojnë me respekt profesorin e tyre. Edhe pse në programet e atëhershme mësimore nuk përfshihej historia e popullit shqiptar, ai kishte guximin tu shpjegonte nxënësve tema të rëndësishme të historisë kombëtare siç ishin: Ilirët, Luftërat e Skënderbeut kundër osmanëve, Lidhja Shqiptare e Prizrenit etj.

Me hapjen e Fakultetit Filozofik – dega e historisë dhe angazhimin e tij si profesor u krijuan parakushtet për aftësimin e ngritjen e kuadrit të ri shkencor. Ai ishte i vetëdijshëm se pa krijimin e kuadrit shkencor vendas nuk mund të studiohet e ndriçohet objektivist e në mënyrë të gjithanshme e kaluara historike e këtyre trevave.

Kështu, me iniciativën e Ali Hadrut, përkrahjen e rektoratit dhe të strukturave politike të kohës, me 1972-1973, u hapën studimet pauniversitare për periudhën e historisë së Kohës Re dhe atë më të Re.

Në studimet pasuniversitare u regjistruan studentë të të gjitha nacio-
naliteteve, si shqiptarë, serbë, boshnjakë e turq. Për 9 vite me radhë,
1972-1981, Ali Hadri ishte udhëheqës e drejtues pothuajse i të gjithë
magjistrantëve e doktorantëve. Në studimet pasuniversitare mësimi
mbahej në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbo-kroate. Në periudhën
që ai e udhëheq në katedrën e historisë magjistruan dhe
doktoruan mbi 70 kandidatë.

Kandidatët që magjis-
truan deri në largimin e aka-
demik Ali Hadrit nga procesi
mësimor janë:



Profesor Hadri në mesin e studentëve

1. Ali Vishko
“Rregullimi administrativ i
Vilajetit të Manastirit”- 1977;

2. Halim Hajdari “Zhvillimi ekonomik-shoqëror, arsimor dhe
kulturor i komunës së Kamenicës në periudhën e ndërtimit socialist
(1945-1980)” – 1980;

3. Lazim Maksuti “Zhvillimi ekonomik i Prishtinës në shek.
XIX dhe në fillim të shek. XX”-1977;

4. Muhamet Mufaku “Prania e shqiptarëve në Siri dhe roli i
tyre në jetën siriane” – 1977;

5. Nanie Gexha “Gjakova në periudhën e ndërtimit socialist”
– 1980;

6. Sylë Dreshaj “Vrella prej themelimit e deri më sot” – 1977;

7. Sreten Martinović “Serbia i Albania u balkanskim ratovi-
nama” – 1976;

8. Tahir Abdyli “Lëvizja kombëtare shqiptare 1903-1908” –
1975;

9. Ramiz Abdyli “Presheva në Lëvizjen Nacional-çlirimtare
1941-1945” – 1977;

10. Halil Alidema “Traktati i Shën Stefanit dhe Ballkani”
1978;

11. Ibrahim Bajgora “Llapi në mes dy luftërave botërore (1918-
1941)-1980;

12. Jusuf Bajraktari "Plani i Brioneve dhe jehona e ndikimit të tij në Kosovë"-1981;
13. Hakif Bajrami "Rrethi i Llapit gjatë viteve 1941-1944" – 1975;
14. Drita Gunga "Lëvizja përparimtare dhe revolucionare e grave në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore" – 1978;
15. Isa Bicaj "Marëdhëniet shqiptaro-malazeze 1900-1916" – 1977;
16. Daut Bislimi "Zhvillimi i historiografisë në Kosovë" – 1978;
17. Bajram Blaku "Lufta e popullit shqiptar për lirinë e gjuhës, të shkollës dhe njësimin e alfabetit në dritën e shtypit shqiptar 1879-1910" – 1979;
18. Jusuf Buxhovi "Lidhja shqiptare e Prizrenit në dokumentet gjermane"-1979;
19. Zija Bylykbashi "Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit dhe veprimtaria e tij 1919-1924" – 1977;
20. Ibrahim Çitaku "Azem Bejta – jeta dhe veprimtaria" – 1977;
21. Islam Dobra "Drenica në Lëvizjen Nacional Çlirimtare 1941-1945" – 1977;
22. Mejd Elezi "Hasi i Prizrenit në Lëvizjen Nacional Çlirimtare 1941-1945" – 1977;
23. Tefik Geci "Bajram Curri në Rilindjen Kombëtare Shqiptare" – 1980;
24. Qamil Gegja "Shtypi i Malit të zi për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1875-1912" – 1976;
25. Flamur Hadri "Gjergj Kastrioti – Skënderbeu në historiografinë serbe" – 1979;
26. Idriz Halabaku "Lëvizja Nacional Çlirimtare në zonën okupuese bullgare 1941-1944" – 1977;
27. Njazi Haxhihamza "Zejtaria e Kosovës në shek. XIX"-1975;
28. Rustem Hasnaj "Zhvillimi i artit dhe kulturës në Mitrovicë me rrethinë 1918-1944" – 1980;

29. Shaban Hashani "Ferizaj dhe rrethina e tij në Lëvizjen Nacional Çlirimtare 1941-1945" – 1979;
30. Izber Hoti "Prishtina dhe rrethina ndërmjet dy luftërave botërore" – 1978;
31. Nait Ipqiu "Kosovo i susedni krajevi u međunarodnoj trgovini 1978-1903" – 1975;
32. Sabile Keçmezi – Basha "Gjendja organizative të PKJ-së në Kosovë 1945-1948" – 1980;
33. Sulltane Kojqini – Ukaj "Gratë e Kosovës në Luftën Nacionalçlirimtare 1941-1945" – 1978;
34. Haki Kasumi "Bashkësitë fetare islame në Kosovë 1818-1945" – 1980;
35. Bukuriye Krasniqi "Reforma Agrare në rrethin e Podrimës me kryeqendër në Rahovec" – 1978;
36. Seit Lipa "Rregullimi Administrativ në Kosovë 1945-1950" – 1977;
37. Ramadan Mujaj "Prizreni në mes të dy luftërave botërore 1918-1941" – 1975;
38. Marjan Prenkaj "Dega e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878-1881" – 1979;
39. Tefik Raka "Lëvizja kulturo-arsimore e shqiptarëve 1908-1912" – 1977;
40. Shkelzen Raça "Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe Revolucioni xhonturk 1898-1912" – 1977;
41. Ilaz Rexha "Lidhja Shqiptare e Prizrenit sipas burimeve osmane 1878-1914" – 1980;
42. Sabri Rexha "Vuçiterna me rrethinë 1918-1941" – 1979;
43. Riza Rexha "Ulqini dhe rrethina 1918-1945" – 1977;
44. Fehmi Rexhepi "Gjilani me rrethinë në vitin 1941" – 1980;
45. Masar Rizvanolli "Asim Vokshi 1909-1937" – 1977;
46. Liman Rushiti "Rregullimi territorial dhe administrative e Kosovës 1918-1941" – 1975;
47. Faruk Salihu "Lëvizja e Rinisë së Kosovës në periudhën e rindërtimit" – 1978;

- 48.Xheladin Shala “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1918-1924” – 1979;
- 49.Muhamet Shatri “Rivaliteti jugosllavo-italian në Shqipëri 1912-1927” – 1977;
- 50.Nehar Shishko “Shqipëria dhe reforma e tanzimatit” – 1977;
- 51.Sabit Uka “Shpërngulja e shqiptarëve të Serbisë juglindore 1877-1878 dhe vendosja e tyre në Sanxhakun e dikurshëm të Prishtinës” – 1979;
- 52.Osman Zeka “Jabllanica si bazë e LNÇ të Kosovës 1941-1945” – 1978;
- 53.Fehmi Pushkollli “Lëvizja Sindikale revolucionare në Kosovë 1919-1941” – 1974;
- 54.Branisllav Joshiq “Aleksinac i okolina y NOR – 1941-1945” -1977;
- 55.Branisllav Kovaqeviq “Cernogorac” i “Glas crnogorca” o albancima – 1977;
- 56.Bogdan P. Ivanoviq “Trepço i njeno radnistvo y NOB 1941-1945” – 1977;
- 57.Dragolub Spasojević “Kruševac od 1918 – 1941” – 1977 ;
- 58.Đorđe Savretović “Komunistička Partija y Prizrenu” 1919 – 1941” – 1978;
- 59.Jakšić Razvigor “NOB y Ibarskom Kollašinu 1941-1945” – 1976;
- 60.Mumćillo Vuksanović “Administrativno i političko urođenje y Đakovičkom srezu između dva svetskog rata” – 1976;
- 61.Mileta Vuqeliq “Malesori i malesorske bune 1908-1912” – 1978;
- 62.Milivoje Vukoviq “Crnogorska vojska od Berlinskog Kongresa do prog svetskog rata 1878-1914” – 1978 ;
- 63.Petar Gllogovac “Uroševac i okolina 1873 – 1912” – 1980;
- 64.Zoran Đorđević “Prizrenska liga u srpskoj štampi” – 1978.

Kandidatët që doktoruan janë:

1. Tahir Abdylil "Zhvillimi i industrisë në Kosovë" – 1978;
2. Hakif Bajrami "Rrethanat shoqërore politike në Kosovë 1918-1941" – 1979;
3. Ismet Dermaku "Roli dhe kontributi i kolonive shqiptare në Ruamani e Bullgari – Rilindja Kombëtare Shqiptare" – 1979;
4. Shukri Rrahimi "Lufta e shqiptarëve për autonomi 1898-1912" – 1974;
5. Njazi Haxhihamza "Tregtia dhe sistemi monetar në mes dy luftërave botërore" – 1979;
6. Seit Lipa "Kosova në periudhën e rindërtimit" - 1980;
7. Liman Rushiti "Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928" – 1980;
8. Fehmi Pushkolli "Sindikatat e Kosovës 1945-1975" – 1977;
9. Millovan Obradović "Agrarska reforma i kolonizacija Kosovo" – 1979;
10. Drita Bakija -Gunga, "Gratë e Kosovës në periudhën e ndërtimit socialist (1945-1978)"-1982;
11. Haris Silajxhiq, "Marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane 1912-1939" -1978.

Për aftësimin dhe ngritjen e gjithanshme të kudrave të reja shkencore, me insistimin e Ali Hadrit, në procesin mësimor u angazhuan profesor eminent në mbajtjen e ligjëratave si nga ish Jugosllavia ashtu edhe nga Shqipëria. Nga ish Jugosllavia mbajtën ligjërata, Akademik Mihajl Apostolski, (Shkup), Branisllav Gjurgjev (Sarajevë), Vuk Vinaver (LubJan) Aleksander Stipçević (Zagreb), Radovan Samargjiç (Beograd). Ndërsa, nga Shqipëria, Aleks Buda, Stefan Pollo, Kristo Frashëri, Luan Omari, Kristaq Prifti, Hysni Myziri etj. Angazhimi i këtyre të fundit si në studimet themelore ashtu edhe në studimet pasuniversitare kishte rëndësi të shumëfishtë jo vetëm në ngritjen e kuadrit të ri shkencor, por edhe të sensibilizimit dhe

frymëzimit kombëtar. Rëndësia kombëtare e angazhimit të profesorëve nga Shqipëria u bë e qartë pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981, ku drejtpërdrejt me kërkesën e qarqeve antishqiptare nga Beogradi, u ndërpre bashkëpunimi kulturor-arsimor me Shqipërinë, ndërsa Ali Hadri u largua nga procesi mësimor dhe u pensionua para kohe.

Fatkeqësisht, në këto rrethana të rënduara politike një pjesë e politikanëve shqiptarë dhe disa intelektualë për të bërë karrierë, u gjuhëzuan para presionit serb dhe morën drejtim të gabuar.

Akademik Ali Hadri është marrë me studimin e kohës së re dhe atë më të re dhe ka botuar shumë punime shkencore të kësaj periudhe. Si njohës shumë i mirë i këtyre dy periudhave historike dhe kërkimet e shumta shkencore që i kishte bërë në arkivat jugosllave, në vende fqinje dhe të Evropës i kishin krijuar atij mundësi objektive për orientim të drejtë të caktimit të temave të magjistraturës e doktoraturës për studiuesit e ri shkencor.

Duke pasur parasysh faktin se deri atëherë shumë pak studiues ishin marrë me studimin e të kaluarës historike të Kosovës, akademik Ali Hadri i drejtoi ata për kërkime shkencore të atyre lëmive që deri atëherë ishin trajtuar fare pak.

Nëse analizojmë me kujdes, temat e caktuara për studiuesit e ri shkencor të udhëhequr nga akademik Ali Hadri mund të vijmë në përfundim se ai kishte përfshirë të gjitha periudhat, si të asaj të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, periudhës midis dy luftërave botërore dhe asaj nga viti 1941-1945 e pas luftës.

Mund të themi lirisht se studiuesit e rinj të udhëhequr nga Ali Hadri në temat e tyre të magjistraturave dhe doktoraturave sollën risi dhe begatuan shkencën e historisë shqiptare dhe ballkanike. Këta studiues të udhëhequr nga Ali Hadri, duke u mbështetur në të dhëna të reja të hulumtuara në arkivat e ish-Jugosllavisë dhe jashtë vendit krijuan parakushtet e favorshme të trajtimit objektiv të kaluarës historike të këtyre trevave. Trajtimi i deriatëhershëm subjektiv i ngjarjeve historike të periudhës së Rilindjes Kombëtare nga historianët serb e malazez e të tjerë, se shqiptarët kanë qenë mbështetësit kryesorë të sundimit osman në Ballkan, se përpjekjet e tyre çlirimtare kanë qenë

krejtësisht të paorganizuara e spontane, të natyrës primitive fisnore e të nxitura nga jashtë. Mirëpo kërkimet e reja shkencore e nxjerrin Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në një dritë të re duke e vendosur atë në kontekstin ballkanik e madje edhe evropian. Studiuesit e rinj që përgatitën temat e magistraturës dhe doktoraturës duke mbështetur në të dhëna të reja shkencore erdhën në përfundime reale se edhe shqiptarët sikurse popujt e tjerë të Ballkanit luftuan me vendosmëri kundër sunduesve osman për çlirim kombëtar dhe formimin e shtetit të tyre të pavarur.

Edhe për periudhën midis dy luftërave botërore deri atëherë ishin bërë shumë pak hulumtime arkivore edhe kishte shumë pak botime. Janë të njohura disa punime të akademik Ali Hadrit për periudhën e lartpërmendur, si për gjendjen dhe pozitën e popullit shqiptar në Jugosllavinë borgjeze. Në këto rrethana shtrohej nevoja që studiuesit e rinj shkencor të angazhohen në ndriçimin e kësaj periudhe duke u mbështetur në faktet e reja dhe trajtimin objektiv historik të saj.

Temat e dhëna dhe hulumtimet e shumta arkivore bënë që kuadrot e reja shkencore të drejtuara nga Ali Hadri të trajtojnë edhe këtë periudhë historike në mënyrë objektive. Trajtimi i temave “Rrethanat shoqërore politike në Kosovë 1918 – 1941”, nga Hakif Bajrami, “Lëvizja kaçake 1918-1928” nga Liman Rushiti, pastaj trajtimi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave midis dy luftërave botërore nga disa autorë si Emine Bakalli, Xheladin Shala, Muhamet Shatri) objektivisht hodhën poshtë pikëpamjet e deriatëherëshme të historiografisë jugosllave. Po ashtu, një rëndësi të madhe shkencore e politike kishte edhe trajtimi i çështjes së Reformës Agrare në Kosovë midis dy luftërave botërore. Akademik Ali Hadri kishte jo vetëm përgatitje të lartë shkencore por edhe sens politik të kohës. Ai për studimin e kësaj çështje angazhoi autorin malazez Milovan Obradoviqin. Trajtimi shkencor i kësaj teme nga një shkencëtar jo shqiptar kishte peshë të veçantë. Autori në fjalë i ndihmuar dhe drejtuar nga akademik Ali Hadri përgatiti temën “Reforma Agrare dhe kolonizimi i Kosovës”. Hulumtimet e shumta të këtij studiuesi në Arkivat e Beogradit, Cetinjës, Shkupit e etj., quan në përfundimin

se në Kosovë faktikisht nuk kishte kryer Reformë Agrare, por ishte ndjek një politikë antishqiptare duke u marrë tokat këtyre të fundit dhe duke kryer kolonizimin e këtyre trevave me popullatë serbo – malazeze.

Po ashtu, vlerë të veçantë shkencore kanë temat e dhëna për ndriçimin objektiv e të gjithanshëm shkencor të periudhës së Luftës së Dytë Botërore.

Akademik Hadri ishte marrë edhe vet me studimin e kësaj periudhe duke vënë themelet e historiografisë së kësaj periudhe. Ai kishte botuar përveç monografisë “Lufta Nacional Çlirimtare në Kosovë 1941-1945” edhe botime të tjera. Mirëpo autorët e deriatëhershëm serb e malazez në shkrimet e tyre e kishin minimizuar pothuajse tërësisht pjesëmarrjen e popullit shqiptar të Kosovës në luftën antifashiste. Synimi i mohimit të kësaj lufte kishte qëllime politike dhe si e tillë ishte e papranueshme. Në këto rrethana akademik Hadri angazhoi studiuesit e rinj në trajtimin e temave të veçanta të angazhimit të popullit shqiptar në Luftën Antifashiste. Studiuesit e rinj shkencor të drejtuar nga akademik Ali Hadri siç janë: Fehmi Rexhepi, Izber Hoti, Muhamet Shatri etj., u morën me studimin regjional siç ishte Lëvizja Nacionalçlirimtare në Gjilan dhe rrethinë, Lëvizja Nacionalçlirimtare në Prishtinë dhe rrethinë, Lëvizja Nacionaçlirimtare në Prizren dhe rrethinë etj. Këta studiues të rinj duke u mbështetur në kërkime të reja shkencore erdhën në përfundim se edhe populli shqiptar i Kosovës ishte krah i Luftës Antifashiste dhe si i tillë ishte radhitur në koalicionin e madh botëror kundër nazifashizmit. Prandaj si të tillë edhe ata sikurse popujt e tjerë të Ballkanit dhe më gjerë duhet t’i gëzonin frytet e asaj lufte madhore kundër forcave nazifashiste.

SUMMARY

ACADEMIK ALI HADRI'S CONTRIBUTION ON RAISING SCIENTIFIC PERSONNEL

Academic Ali Hadri is among accentuated personalities of Albanian world. He dedicated his life to education because it brought national conscience.

As lecturer in cathedra of history, Ali Hadri has given a great contribution. During the period between 1972 and 1981, he was directing post-graduate studies, when over 70 candidates received master and doctorate degrees.

Ali Hadri has published many historic work and has explained objectively and comprehensively the past history of Albanian people. In professional scientific manner, relaying on abundant historical sources, Hadri successfully refuted Serbian historiography for deliberate tendencies on the history of Albanian people.

For his contribution in Albanian historiography and development of research personnel, Hadri will be eternally honoured by Albanian intellectual world.

TRASHËGIMIA PUBLICISTIKE E ALI HADRIT PAS VITIT 1981

Pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, si dihet, push-teti jugosllav i asaj kohe ndërmori një fushatë të egër kundër shqiptarëve. Në të vërtetë ishte kjo njëra ndër fushatat e fundit të Serbisë, të ndërmarra kundër asaj pjese të popullit shqiptar që pas vendimeve të Konferencës së Londrës të vitit 1913 dhe Traktatit të Versajës të vitit 1919 nga robëria shumëshekullore osmane kaloi nën robërinë sllave.



Gjatë gati tërë shekullit të kaluar ndaj shqiptarëve që ngelën jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë, në Jugosllavi dhe në Greqi, u ushtrua një trysni e vrazhdë jo vetëm duke ua shkelur të drejtat themelore, por edhe duke e dëbuar një pjesë të kësaj popullsie nga trojet e veta shekullore, e cila u detyrua të merrte botën në sy, duke u vendosur kryesisht në Turqi.

Gjatë këtij shekulli shqiptarët e Kosovës patën vetëm një periudhë të shkurtër kohore, nga viti 1966 deri në vitin 1981, kur gëzuan një liri relative dhe pak a shumë të drejta individuale dhe kolektive. Ndërkaq, kur në vitin 1981 nëpërmjet demonstratave paqësore u shtruan kërkesat që Kosova, në atë kohë krahinë autonome, por njëherësh edhe element konstitutiv i federatës së atëhershme jugosllave, të bëhej e barabartë me republikat e tjera të kësaj federate, këto kërkesa u shtypën me gjak, me disa dhjetëra të vdekur, me qindra të plagosur dhe me mijëra të burgosur dhe të ndëshkuar me dënime të rënda deri në njëzet vjet burgim. Mirëpo këto demonstrata nuk përfunduan vetëm me shtypjen e tyre. Ishin ato një vjeggë për të ni-

sur një fushatë të orkestruar dhe të pandërprerë kundër shqiptarëve me të gjitha mjetet që kishte në dorë Serbia, nëpërmjet mediave të shkruara dhe elektronike, nëpërmjet botimit të një biblioteke të tërë librash antishqiptare, fushatë kjo e cila përfundoi me heqjen e dhunshme të autonomisë së Kosovës në vitin 1989 dhe me dëbimin e rreth gjysmës së popullsisë shqiptare të Kosovës dhjetë vjet më vonë, kur u vranë rreth pesëmbëdhjetë mijë shqiptarë, u dëbua me dhunë jashtë kufijve të Kosovës rreth gjysma e popullsisë shqiptare të saj, do të thotë rreth një milion njerëz, ndërsa duke zbatuar taktikën e tokës së djegur, për t'ua pamundësuar kthimin të dëbuarve në vatrat e tyre, paramilitarët dhe ushtria e policia serbe dogjën qindra fshatra dhe pjesë të tëra të shumë qyteteve të Kosovës.

Demonstratat e vitit 1981 qenë praktikisht kulmi i një qëndrese të shqiptarëve të Kosovës gati gjatë tërë një shekulli për ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar dhe fillimi i fundit të flakjes së zgjedhës serbe, realizimi i ëndrrave dhe i flijimeve të jetëve të mijëra atdhetarëve shqiptarë me të cilët u pagua pavarësia që gëzon Kosova sot.

Gjatë fushatës që ndërmori Serbia pas demonstratave të vitit 1981, në shënjestër u vu posaçërisht inteligjencia shqiptare dhe arsimi në gjuhën shqipe. Ndër masat e para që u ndërmorën kundër Universitetit të Kosovës, të etiketuar si “kështjellë e nacionalizmit shqiptar”, qe përjashtimi nga puna i një numri profesorësh të shquar të tij, ndër të cilët po përmendim rektorin e asaj kohe të këtij Universiteti, akademikun Gazmend Zajmi dhe akademikët Ali Hadri dhe Fehmi Agani.

Ndër këta intelektualë objekt sulmesh të posaçme dhe të pandërprera u bë Ali Hadri. Si historian i shquar, çfarë ishte, i cili ndër të tjera me guxim u ishte kundërvënë historianëve dhe politikanëve serbë në përpjekjet e tyre për shtrembërimin dhe falsifikimin e fakteve historike, veçanërisht lidhur me pjesëmarrjen e popullit shqiptar në luftën e koalicionit antifashist gjatë Luftës së Dytë Botërore, nga fushata që u ndërmor kundër tij doli se një kohë të gjatë ishte mbledhur një mllef i madh ndaj tij jo vetëm për shkrimet e tij të shumta, por edhe për organizimin e punës shkencore në Institutin e

Historisë së Kosovës, drejtor shumëvjeçar i të cilit ishte, për tezat e shumta të magistraturave dhe të doktoratave, mentor ose anëtar i komisioneve të mbrojtjes të të cilave ishte, për bashkëpunimin e vënë ndërmjet Institutit të Historisë së Kosovës me Institutin e Historisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, për punën e madhe që bëri ai gjatë organizimit të konferencave shkencore të 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut dhe të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Njëra ndër arsytet për ndërmarrjen e masave kundër këtyre akademikëve ishte edhe kundërshtimi i tyre, si edhe i pjesës më të madhe të anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndaj trysnisë së ushtruar ndaj tyre me kërkesën që t'i kritikonin botërisht demonstratat e vitit 1981 si veprime armiqësore. Derisa shumica e profesorëve të përjashtuar, pasi qëndruan një kohë pa punë, më vonë u morën me punë të tjera, Ali Hadri, pasi i plotësonte kushtet, doli në pension. Pushteti serb, kuptohet nëpërmjet shërbëtorëve të tij që kishte në organet e pushtetit në Kosovë, bëri përpjekje që këtë intelektual të shquar shqiptar ta pengonte të gëzonte edhe pensionin e merituar dhe, për ta arritur këtë qëllim, ngriti padi në gjyq se gjoja e paska falsifikuar datëlindjen e tij. I lindur në Lushnje, Ali Hadri e kishte në rregull tërë dokumentacionin e duhur për marrjen e pensionit, mirëpo për diskreditimin e tij u gjet si vjegë pohimi se gjoja organet përkatëse të gjendjes civile të vendlindjes së tij i paskan lëshuar certifikatë të lindjes false. Ishte ky rast që media të panumërta serbe, të shkruara dhe elektronike, t'u binin të gjitha kambanave për diskreditimin e historianit të shquar shqiptar. Pushteti serb nuk ishte i kënaqur që e largoi nga puna në një kohë kur ai mund të vazhdonte të jepte ndihmesë të madhe si profesor në Degën e historisë të Fakultetit Filozofik dhe në ngritjen e kuadrove të reja shkencore, se ia ndaloi hyrjen në ndërtesën e Arkivit të Kosovës, ku ishte i vendosur edhe Instituti i Historisë, por bëri përpjekje që edhe ta fuste në burg.

Ndaj të gjitha këtyre sulmeve Ali Hadri mbajti qëndrim burrëror. Ai jo vetëm se i përballoi ato pa iu trembur syri, por reagoi me guxim kundër tyre. Kështu, në vitin 1983, pamfletit të Milorad Jankoviçit Shqipëria e Madhe, lodrat e spiunazhit dhe legjendat e re-

jshme, të botuar në gjashtë vazhdimë në revistën e Beogradit Duga, i përgjigjet me punimin *Pseudoshkenca është e dëmshme*,¹ të botuar në po këtë revistë. Një autori tjetër serb, Dimitrije Bogdanoviçit, një pamfleti të tij antishqiptar, të botuar në gazetën *Književne novine*, në vitin 1985, Ali Hadri i përgjigjet po në këtë gazetë me punimin *Pseudoshkenca e Bogdanoviçit në shërbim të nacionalizmit*.² Autorit të pamfletit Islamizimi i Maqedonisë, të botuar në disa vazhdimë në gazetën e Shkupit *Večer*, prej 25.9 deri më 21.10 1980, Nijazi Limanovit, i përgjigjet me punimin Disa fjalë mbi përhapjen e islamizmit në Ballkan.³

I zëmë në gojë këto tri punime, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të botuara në përmbledhjen e studimeve të Ali Hadrit Marrëdhëniet shqiptare-jugosllave, ndërsa meqë pas demonstratave të vitit 1981 kam vazhduar marrëdhëniet intensive miqësore që kam mbajtur me Ali Hadrin gjatë një çerek shekulli, jam në dijeni edhe për një varg punimesh të tjera publicistike të tij, të shkruara drejtpërdrejt në gjuhën serbe, të dërguara për botim organeve të ndryshme periodike në këtë gjuhë, si edhe për punime në gjuhën shqipe, për botim në periodikun shqiptar. Ishin këto punime qoftë përgjigje shkrimeve të ndryshme antishqiptare, qoftë shkrime për t'u mbrojtur nga sulmet dhe shpifjet që botoheshin kundër personalitetit dhe veprës së tij. Kam pasur kënaqësinë që shumë ndër dorëshkrimet e këtyre punimeve t'i lexoja dhe të diskutonim për to me autorin e tyre para se të dërgoheshin për botim. Mirëpo, shumë shkrime të tij në gjuhën serbe nuk e panë kurrë dritën, ngase redaksitë e revistave dhe të gazetave të cilave iu dërguan nuk i botonin. Duke mbajtur parasysh rrethanat e kohës për të cilën po bëjmë fjalë, ndodhte të mos botoheshin as shkrimet e tij dërguar të përkohshmeve në gjuhën shqipe.

¹ Ky punim, i përkthyer nga serbishtja në shqipet, me titullin *Pseudoshkenca është e dëmshme*, u botua në përmbledhjen e punimeve: Ali Hadri, *Marrëdhëniet shqiptare-jugosllave*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2003, f. 235-262.

² Shih *Pseudoshkenca e Bogdanoviçit në shërbim të nacionalizmit*, po aty, f. 263-271.

³ Shih *Mbi përhapjen e islamizmit në Ballkan*, po aty, f. 273-282.

Në një rast, më kujtohet, duke parë se sa shumë kohë po humbte miku im për këto shkrime të cilat nuk e shihnin dritën, e vura në diskutim çështjen se sa ishte punë me vend të vazhdonte të shkruante dhe t'u dërgonte redaksive të ndryshme shkrime një pjesë e madhe e të cilave nuk u botuan kurrë.

Kësaj përsiatjeje time, Ali Hadri, aty për aty, iu përgjigj:

- Vëllaçko, ti e di se unë jam historian, e historianët shkruajnë jo vetëm për t'i parë të botuara shkrimet e tyre, por shkruajnë edhe për arkiv. Jam i bindur se këto shkrime, të cilat ti po i lexon në dorëshkrim, një ditë do t'i lexosh të botuara, shtoi ai.

Ishte kjo përgjigje në përputhje me karakterin optimist të tij. Kur bisedonim për të ardhmen e Kosovës, ai thoshte se herët a vonë Kosova do ta flakte zgjedhën serbe, se gjaku i derdhur për lirinë e saj nuk do të ngelte pa u kurorëzuar me pavarësinë e këtyre trojeve shqiptare.

Këto shkrime janë me rëndësi jo vetëm për përmbajtjen e tyre. Ato janë një dëshmi për karakterin e fortë të autorit të tyre, për guximin e tij, për përkushtimin e tij për çështjen tonë kombëtare. Ato dolën nga pena e tij në një kohë të ligë, atëherë kur intelektualët shqiptarë në Kosovë ishin të mbikëqyrur dhe të ndjekur në çdo hap, kur çdo veprim i tyre regjistrohej në dosjet e hapura të tyre nga shërbimet e fshehta të policisë, të cilat çdo ditë pasuroheshin nga bashkëpunëtorët e saj me të dhëna të reja. Ishte pra kohë kur duhej pasur shumë kujdes tek bisedoje me dikë, duhej të mendoje mirë para se ta hapje gojën. Akademiku ynë, në këto rrethana, jo vetëm që nuk ngurroi ta hapte gojën, por qëndrimet e tij i vinte në letër dhe kërkonte që ato të bëheshin publike, pa u stepur për pasojat e mundshme të tyre.

Sulmeve, cak i të cilave ishte, ai u përgjigjej me guxim shembullor. Më kujtohet një përgjigje e njohur e Ali Hadrit kur pati deklaruar:

- "Unë do ta ndaj fatin tim me atë të popullit tim".

Në mos u gabofsha, kjo përgjigje sypatrembur ndaj kërcënimeve që i bëheshin, është botuar në njërin ndër shkrimet e tij të kohës për të cilën po bëjmë fjalë.

Ali Hadri pra shkruante jo vetëm për të botuar, por edhe për arkiv. Mirëpo cili është fati i arkivit të tij? Kjo pyetje ka arsyen e vet përse shtrohet, duke mbajtur parasysh rrethanat nëpër të cilat kaloi

Kosova në vitin 1999, kur një pjese të madhe të vendbanimeve të Kosovës iu vu zjarri nga paramilitarët dhe ushtarakët serbë, ndër të cilat qyteti i Pejës pësoi posaçërisht. Në këtë kohë, nga njoftimet që kam, në shtëpinë e Ali Hadrit, në Pejë, ka qenë i vendosur shtabi i ushtrisë serbe. Ç'u bë me arkivin e tij? Në qoftë se dorëshkrimet e historianit tonë janë ruajtur, shkrimet e tij publicistike, të botuara dhe të pabotuara, mendoj se duhet të shohin dritën. Sido që të jetë, do të ishte mëkat që këto shkrime të lihen në harresë.

Duke u nisur nga një shënim në fund të faqes në punimin *Pseudoshkenca është e dëmshme*, të botuar në përmbledhjen e përmendur të punimeve *Marrëdhëniet shqiptare-jugosllave*, ku lexojmë se ky punim “është reagim i botuar në revistën Kosova nr. 18/19, Prishtinë 1996, i akademik Ali Hadrit ndaj fejttonit në vazhdimet të Milorad Jankoviqit” dhe se “pjesa tjetër botohet për herë të parë”,⁴ duke u mbështetur në pjesën e fundit të këtij citati, më mban shpresa se dorëshkrimeve të arkivit të historianit tonë nuk u kanë humbur gjurmët. Po qe se kjo shpresë e imja del e kotë, atëherë më thotë mendja se shkrimet e tjera të kësaj kohe, të botuara në periodikun në gjuhën serbe dhe shqipe, duhet të mblidhen dhe të botohen, në gjuhën shqipe, në një përmbledhje të përbashkët.

Është kjo një pjesë e trashëgimisë së Ali Hadrit e cila nuk do të ishte mirë të lihej mënjanë, një detyrim të cilin e kemi ndaj përkushtimit dhe veprimtarisë së historianit tonë në periudhën e fundit të jetës së tij. Ndërkaq, po qe se del se janë ruajtur dorëshkrimet e tij, ato bashkë me shkrimet e tjera, të botuara në të përkohshme të ndryshme, në gjuhën shqipe dhe serbe, duhet të mblidhen dhe të botohen së bashku në një përmbledhje në gjuhën shqipe, në një ose në më shumë vëllime.

Në botimin e veprave të plota të Ali Hadrit, të cilat shpresoj se do ta shohin dritën, do të duhet të përfshihen gjithsesi edhe shkrimet e periudhës për të cilën bëmë fjalë, mirëpo pa e pritur botimin e veprave të plota, shkrimet e periudhës pas vitit 1981 duhet të botohen sa më parë, si dëshmi të një segmenti të jetës së kësaj periudhe të historisë sonë dhe si ndihmesë për ndriçimin sa më të plotë të kësaj periudhe.

⁴ Shih Ali Hadri, *Marrëdhëniet shqiptare-jugosllave*, f. 235.

SUMMARY

ALI HADRI'S JOURNALISTIC HERITAGE AFTER 1981

After peaceful demonstrations of Albanians in 1981, in which they called for Kosova's equality with the other republics in Yugoslav Federation, were crushed in blood; Serbia conducted a repressive anti-Albanian campaign, aiming primarily on its intellectuals.

Academic Ali Hadri, a member of intellectual elite, who was in epicentre of Serbian oppression, not only that was expelled from job, but he was also banned to enter in Institute of History, which he had founded. At the same time, Hadri was pensioned, although there were efforts for denial of his pension right, as he allegedly faked his birth-date, claims on which he was later taken to court.

On the other hand, against professor Hadri was initiated a continual media campaign, which he confronted without limiting oneself to bravely respond on accusation, but also kept challenging anti-Albanian rhetoric of post-1981, with its representatives as Milorad Jankovic, Dimitrije Bogdanovic and Nijazi Limanov; just as he had done priorly against articles of Svetozar Vukmanovic – Tempo. Although, a part of Academic Hadri's writings was published, his archive of manuscripts should be researched, if survived the 1999 War in Kosova. Writings of this accentuated historian after 1981 could be published as a synopsis compilation.